



## PROCESVERBALI

Mbledhja e Komitetit për Komunitete e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur me datë: **24.01.2025** me fillim në orën **10:10**. Këtë mbledhje e kryesoi Kryesuesi i Komitetit për Komunitete **z. Bajram Morina**.

**Kryesuesi:** Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! Faleminderit për praninë tuaj. Përshëndetje për përfaqësuesit e KFOR-it, OSBE-së, anëtarët e Komitetit për Komunitete dhe të gjithë të pranishmit. Ky është takimi i **parë** për vitin 2025, për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

### REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i raportit vjetor i Komitetit për Komunitete për vitin 2024;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës për vitin 2025;
4. Të ndryshme.

**Kryesuesi:** Atëherë, ky është rendi i ditës për sot. Po e vendosim në votim si të tillë. Kush është “për”?... Me shumicë unanime aprovohet rendi i ditës.

#### 1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

**Kryesuesi:** A ka dikush ndonjë gjë rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Konstatohet që unanimitasht aprovohet pika e parë e rendit të ditës.

#### 2. Shqyrtimi i raportit vjetor i Komitetit për Komunitete për vitin 2024:

**Kryesuesi:** Atëherë, po e lexoj raportin në pika të shkurtra. Raporti është pasqyrim i aktiviteteve dhe i angazhimeve të Komitetit për Komunitete, për periudhën janar-dhjetor 2024. Synimet kryesore përfshijnë: Përmirësimi i gjendjes së komuniteteve joshumicë në Komunën e Rahovecit, përmirësimi i infrastrukturës, zhvillimi i aktiviteteve kulturore-arsimore, fushata sensibilizuese, zhvillimi profesional, mbështetja e bizneseve për komunitetin joshumicë në komunën e Rahovecit etj. Komiteti për Komunitete i Komunës së Rahovecit, gjatë vitit 2024 ka mbajtur 6 takime, duke u angazhuar në zhvillim dhe mbështetje të komuniteteve: rom, ashkali, egjiptian, serb dhe boshnjak. Për më gjerësisht, raportin e keni në emailin tuaj dhe për çdo pyetje jam këtu për t’u përgjigjur. Atëherë, nëse nuk ka pyetje, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Unanimitasht aprovohet pika e dytë.

#### 3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës për vitin 2025:

**Kryesuesi:** Atëherë, e kemi bërë një plan të punës që përfshin të gjitha aktivitetet që do t’i realizojmë gjatë vitit 2025. Pikat e rendit të ditës dhe vizitat. Janë planifikuar së paku të mbahen 12 mbledhje gjatë vitit. Gjithashtu edhe planin e punës e keni nëpër emailin tuaj. Për çdo pyetje, sugjerim apo edhe ide tjetër, atëherë ne jemi këtu për përgjigje.

**Faton Ramadani:** Faleminderit, kryesues! Ka disa gabime teknike këtu, përfshirë edhe këtë që duhet t’i mbajmë më së paku 12 mbledhje, jo 12, por më së paku 6. Si dhe në fund të plani është emri i kryesuesit të kuvendit, Arbër Zenuni, në këtë rast duhet të jetë i juaji.

**Kryesuesi:** Faleminderit, Faton! Po, do t'i bëjmë këto përmirësime. Nëse edhe dikush nuk ka ndonjë gjë për të shtuar, e vendosim në votim. Kush është për?... Kundër?... Unanimisht aprovet plani i punës për vitin 2025.

#### 4. Të ndryshme:


**Merisa Sharku:** Faleminderit, kryesues! Më mirë do të ishte nëse do ta kisha marrë fjalën para aprovimit të planit të punës, por, ndoshta nuk është problem që ndërkohë mund të plotësohet dhe ndryshohet.

**Skender Hamza:** Po, Merisë! Në çdo mbledhje mund të ketë pika shtesë.

**Kryesuesi:** Atëherë, nëse nuk keni ndonjë gjë shtesë, ju falënderoj për vëmendje dhe shihemi në mbledhjen e radhës!

**Mbledhja përfundoi: 10:40**

**Procesmbajtësi:**

  
Albion Krasniqi

**Kryesuesi i mbledhjes:**

  
Bajram Morina

